

TË DREJTOJMË SJELLJEN E FËMIJËS



Eshte e rëndësishme që të drejtohet sjellja e një fëmije. Jepini nxënësve detyra të ndryshme dhe qëndroni pranë tyre për t`i udhëzuar. Gjatë kësaj kohe lavdërojini dhe tregojuni që po bëjnë një punë të mirë. Kushtojini vëmendje përpjekjeve të nxënësve.

Nxënësit ndihen të vlerësuar kur përpjekjet e tyre shpërblehen. Ju mund t`i kërkoni çdo nxënësi që të marrin një kuti me vete në klasë dhe sa herë që sillen në mënyrë pozitive, të hedhin brenda nje top te vogël letre. Nxënësit që e mbushin kutinë më shpejt, mund të marrin privilegje të ndryshme, si për shembull kujdestarinë e klasës.